

Material informues mbi veprimtarinë me letra me vlerë që klientët kryejnë me Bankën Amerikane të Investimeve*

Në rast blerjeje të një Bono Thesari/Obligacioni nëpërmjet ABI Bank, më poshtë janë komisionet e aplikuara nga Banka sikurse sot, datë 23.10.2017:

Letra me Vlere në LEK

Bono Thesari të Qeverisë	Obligacione të Qeverisë
0.10%, Min LEK 1,000 & Max LEK 5,000	0.10%, Min LEK 1,000 & Max LEK 5,000-Çdo vit

Letra me Vlere në EUR,USD*

Bono Thesari të Qeverisë	Obligacione të Qeverisë
0.10%, Min EUR,USD 10 & Max EUR,USD 40	0.10%, Min EUR,USD 10 & Max EUR,USD 40-Çdo vit

1. Blerje Bono Thesari/Obligacion në ankand primar

Shembull 1: Blerje Bono Thesari në LEK

Klienti merr pjesë në ankand primar për blerje Bono Thesari për vlerën nominale 2,000,000 LEK. Sipas kushteve të punës së mësipërme, klienti paguan në maturim të letrës komisionin 0.1% të shumës, i cili është 2,000 LEK (2,000,000*0.1%=2,000).

Shembull 2: Blerje Bono Thesari në LEK

Klienti merr pjesë në ankand primar për blerje Bono Thesari në vlerën nominale 500,000 LEK. Sipas kushteve të punës së mësipërme, klienti paguan në maturim të letrës komisionin 0.1% të shumës, por duke qenë se në këtë rast rezultojnë 500 LEK, atëherë do të aplikohet komisioni minimal prej 1,000 LEK.

Shembull 3: Blerje Obligacioni në LEK

Klienti merr pjesë në ankand primar për blerje Obligacioni në vlerën nominale 3,000,000 LEK. Sipas kushteve të punës së mësipërme, klienti paguan në datën e pagesës së kuponit të parë komisionin vjetor 0.1% të shumës, i cili është 3,000 LEK dhe paguhet çdo vit.

Shembull 4: Blerje Obligacioni në LEK

Klienti merr pjesë në ankand primar për blerje Obligacioni në vlerën nominale 6,000,000 LEK. Sipas kushteve të punës së mësipërme, klienti paguan në datën e pagesës së kuponit të parë komisionin vjetor 0.1% të shumës. Duke qenë se në këtë rast rezultojnë 6,000 LEK, atëherë do të aplikohet komisioni maksimal prej 5,000 LEK. Ky komision paguhet çdo vit deri në maturim të Obligacionit.

2. Tregtim Bono Thesari ose Obligacioni

Në rastin e blerjes/shitjes së letrave me vlerë përpara datës së maturimit të tyre, Banka Amerikane e Investimeve nuk aplikon komision për transaksionin. Në këto raste transaksioni kryhet me cmimin e llogaritur nga Banka për blerjen ose shitjen e letrës me vlerë, i cili përcaktohet nga yield-i që kuotohet nga Banka dhe ditët e mbetura të letrës deri në maturim. Formula e llogaritjes së cmimit për Bonot e Thesarit dhe Obligacionet është si më poshtë:

$$Cmimi\ i\ Bonove\ te\ Thesarit = \frac{Vlera\ Nominale}{1 + \frac{Yield}{365} \times \text{ditet e mbetura deri ne maturim}}$$

$$Cmimi\ i\ Obligacioneve = \frac{C}{(1+y_m/2)^{t_1}} + \frac{C}{(1+y_m/2)^{t_2}} + \dots + \frac{C}{(1+y_m/2)^{t_i}} + \frac{C+N}{(1+y_m/2)^{t_n}}$$

ku:

$$t_i = \frac{\tau_i - cut_off}{180}$$

C = Kuponi

N = Vlera Nominale

y_m = Yield-i i tregut

τ_i = Data e pagesës së kuponit

Cut_off = Data e llogaritjes së cmimit

Më poshtë janë disa shembuj mbi menyrën e llogaritjes së cmimit.

Shembull 5: Banka blen Bono Thesari nga klienti

Klienti kërkon të shesë Bono Thesari me maturitet të mbetur 180 ditë, me vlerë nominale 2,000,000 LEK. Yield-i i blerjes që kuotohet nga ABI Bank është 2.5%. Cmimi i blerjes, bazuar në formulën e mësipërme rezulton 1,975,643 LEK.

Shembull 6: Banka shet Bono Thesari nga portofoli i saj

Klienti bie dakort të blejë një Bono Thesari me maturitet të mbetur 320 ditë, me vlerë nominale 1,000,000 LEK. Yield-i i shitjes që kuotohet nga ABI Bank është 2.2%. Cmimi i shitjes, bazuar në formulën e mësipërme rezulton 981,077 LEK. Në maturim të letrës aplikohet komisioni 0.1% e shumës prej 1,000 LEK, i cili perfaqëson komisionin për shërbimin e kujdestarisë.

Shembull 7: Banka blen Obligacion nga klienti

Klienti kërkon të shesë Obligacion me maturitet të mbetur 1,600 ditë, me vlerë nominale 1,500,000 LEK dhe kupon 3.5%. Yield-i i blerjes që kuotohet nga ABI Bank është 4.5%. Cmimi i pastër i blerjes, bazuar në formulën e mësipërme rezulton 1,440,941 LEK.

Shembull 8: Banka shet Obligacion nga portofoli i saj

Klienti bie dakort të blejë një Obligacion me maturitet të mbetur 1,200 ditë, me vlerë nominale 2,000,000 LEK dhe kupon 5.5%. Yield-i i shitjes që kuotohet nga ABI Bank është 4.1%. Cmimi i pastër i shitjes, bazuar në formulën e mësipërme rezulton 2,085,064 LEK. Për shërbimin e kujdestarisë, klienti do paguajë komisionin prej 2,000 LEK, i cili është komision vjetor dhe paguhet në datën e kuponit të ardhshëm.

*Ky material ka qëllim informues. Klienti duhet t'i referohet Kushteve të Punës në fuqi në datën e transaksionit.